


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2016

Tiranë, më 29 Mars 2016: Në muajin Shkurt 2016 eksportet e mallrave arritën vlerën 18 mld lekë, duke u ulur me 4,5 % në krahasim me Shkurt 2015 dhe duke u rritur me 7,2 % në krahasim me Janar 2016. Importet e mallrave në muajin Shkurt 2016 arritën vlerën 42 mld lekë, duke u rritur me 6,8 % në krahasim me Shkurt 2015 dhe 19,1 % në krahasim me Janar 2016. Deficiti tregtar i këtij muaji është 24 mld lekë, duke u rritur me 16,9 % krahasuar me Shkurt 2015 dhe 29,6 % në krahasim me Janar 2016.


Fig. 1 Qarkullimi i mallrave, Janar 2015 – Shkurt 2016 (miliardë lekë)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Ulja vjetore e eksporteve prej 4,5 % këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -12,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,7 pikë përqindje, “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me -2,0 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +9,3 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” kanë kontribuar me +2,8 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me +0,4 pikë përqindje.


Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 6,8 % këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +3,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +2,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,6 pikë përqindje dhe “Prodhime druri dhe letre” me -0,2 pikë përqindje.


Fig.3 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve



Në muajin Shkurt 2016, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2015 janë: Italia me 6,0 %, Greqia me 3,4 % dhe Gjermania 32,6%. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kosova me 34,9 %, Maqedonia me 16,7 %, dhe Kina me 65,9 %.

Në muajin Shkurt 2016, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2015 janë: Italia me 11,7 %, Kina me 7,3 % dhe Greqia me 11,2 %. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Serbia me 20,6 %, SHBA me 7,9 % dhe Franca me 3,0 %.

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2016



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 71,0 % të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2016, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 86,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 64,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia (41,0 %), Kina (7,1 %) Greqia (6,7 %), dhe Gjermania (6,5 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (milionë lekë)

Vitet	Muajt	Eksporte	Importe	Bilanci Tregtar	% e mbulimit
2000		37.037	157.109	-120.072	23,6
2001		44.096	190.155	-146.059	23,2
2002		47.490	210.368	-162.878	22,6
2003		54.487	225.983	-171.496	24,1
2004		62.121	236.072	-173.951	26,3
2005		65.818	262.191	-196.373	25,1
2006		77.405	299.147	-221.742	25,9
2007		97.171	376.194	-279.023	25,8
2008		112.572	439.894	-327.322	25,6
2009		104.515	428.839	-324.324	24,4
2010		161.548	477.768	-316.220	33,8
2011		196.897	544.004	-347.107	36,2
2012		213.030	528.490	-315.460	40,3
2013		246.397	517.378	-270.981	47,6
2014		255.759	552.279	-296.520	46,3
2015		243.183	544.581	-301.398	44,7
2014	01 - 14	17.869	34.922	-17.053	51,2
	02 - 14	20.304	39.193	-18.889	51,8
	03 - 14	21.302	42.478	-21.176	50,1
	04 - 14	22.720	44.308	-21.588	51,3
	05 - 14	25.317	48.241	-22.924	52,5
	06 - 14	22.490	49.351	-26.860	45,6
	07 - 14	22.911	47.158	-24.247	48,6
	08 - 14	18.582	44.601	-26.019	41,7
	09 - 14	21.324	47.402	-26.078	45,0
	10 - 14	22.269	52.436	-30.167	42,5
	11 - 14	21.380	48.080	-26.700	44,5
	12 - 14	19.290	54.108	-34.818	35,7
2015	01 - 15	17.763	35.245	-17.482	50,4
	02 - 15	18.392	38.889	-20.497	47,3
	03 - 15	22.179	44.437	-22.258	49,9
	04 - 15	20.783	43.696	-22.913	47,6
	05 - 15	24.098	44.382	-20.284	54,3
	06 - 15	24.158	48.952	-24.794	49,4
	07 - 15	22.540	52.412	-29.872	43,0
	08 - 15	15.376	40.126	-24.750	38,3
	09 - 15	20.403	44.027	-23.624	46,3
	10 - 15	20.204	50.249	-30.044	40,2
	11 - 15	19.468	49.017	-29.549	39,7
	12 - 15	17.817	53.150	-35.333	33,5
2016	01 - 16	16.380	34.876	-18.497	47,0
	02 - 16	17.560	41.523	-23.963	42,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Shk.-15	Shk.-16	Jan.- Shk 2015	Jan.- Shk 2016	Shk.-15	Shk.-16	Jan.- Shk 2015	Jan.- Shk 2016
Vendet e BE-së	13.780	15.108	27.500	29.225	23.108	26.827	42.020	47.289
Austri	623	147	1.099	237	242	639	506	827
Mbretëri e Bashkuar	70	29	115	59	282	377	649	586
Gjermani	534	708	1.166	1.332	2.635	3.128	4.782	5.344
Greqi	763	789	1.335	1.464	2.829	3.144	5.524	5.740
Itali	10.077	10.686	19.670	21.069	12.091	13.510	21.591	24.819
Spanjë	277	551	1.688	821	492	670	875	1.171
Kroaci	37	41	66	76	373	262	529	516
Të tjera të BE-së	1.398	2.157	2.360	4.167	4.165	5.097	7.564	8.285
Kinë	622	212	1.196	575	3.712	3.984	7.262	7.405
Kosovë	1.583	1.032	2.357	1.748	426	299	764	524
Maqedonia	332	276	518	456	679	426	1.131	794
Rusi	-	1	-	1	772	185	1.786	889
SHBA	714	91	918	188	877	808	1.695	1.470
Turqi	577	61	1.898	160	2.488	2.919	5.446	5.717
Ukrainë	-	23	3	34	213	221	624	330
Zvicër	43	109	72	181	890	543	2.034	1.147
Të tjera	741	647	1.693	1.370	5.724	5.311	11.371	10.835
Gjithsej	18.392	17.560	36.155	33.940	38.889	41.523	74.134	76.399

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shk.-15	Shk.-16	Jan.- Shk 2015	Jan.- Shk 2016	Shk.-15	Shk.-16	Jan.- Shk 2015	Jan.- Shk 2016
Gjithsej	18.392	17.560	36.155	33.940	38.889	41.523	74.134	76.399
Ushqime, pije, duhan	1.146	1.660	2.261	3.122	6.988	7.129	13.423	13.558
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.710	2.331	8.356	4.379	4.861	3.462	9.179	8.003
Produkte kimike dhe plastike	320	289	564	537	5.360	6.479	10.378	10.409
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	177	243	346	518	986	1.158	1.851	2.176
Prodhime druri dhe letre	665	629	1.321	1.221	1.756	1.661	2.970	2.984
Tekstile dhe këpucë	7.146	8.860	14.519	17.300	4.834	6.100	9.223	10.975
Materiale ndërtimi dhe metale	2.607	2.111	5.763	4.134	4.662	4.979	9.623	8.733
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.259	892	2.301	1.711	8.159	9.093	15.148	17.148
Të tjera	362	544	722	1.019	1.283	1.461	2.338	2.415

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, Janar-Shkurt 2016 (milionë lekë)

Grup-mallrat	Itali	Kosovë	Greqi	Gjermani	Të tjera
Gjithsej	21.069	1.748	1.464	1.332	8.327
Ushqim, pije duhan	1.422	283	284	210	922
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	568	348	48	81	3.334
Produkte kimike dhe plastike	245	117	39	20	116
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	474	0	7	3	34
Prodhime druri dhe letre	963	37	105	13	104
Tekstile dhe këpucë	13.861	10	731	837	1.861
Materiale ndërtimi dhe metale	1.842	691	186	92	1.323
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.188	87	19	60	357
Të tjera	506	174	45	16	277

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, Janar-Shkurt 2016 (milionë lekë)

Grup-mallrat	Itali	Kinë	Greqi	Turqi	Të tjera
Gjithsej	24.819	7.405	5.740	5.717	32.718
Ushqim, pije duhan	2.485	63	2.083	682	8.245
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	2.787	2	465	48	4.701
Produkte kimike dhe plastike	2.193	606	937	835	5.837
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.803	126	11	25	211
Prodhime druri dhe letre	1.010	146	334	371	1.123
Tekstile dhe këpucë	6.014	1.231	483	1.920	1.327
Materiale ndërtimi dhe metale	2.487	2.128	837	653	2.627
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	5.355	2.618	377	964	7.835
Të tjera	685	485	213	218	813

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri